

STATUTI I SHOQËRISË RECRUITMENT AFFILIATE SH.P.K.

Në datën e përcaktuar në fund të këtij dokumenti, ortakët themelues vendosën miratimin e këtij Statuti për rregullimin e veprimtarisë së shoqërisë, me termat si më poshtë:

KREU I

Emri – Objekti – Selia – Kohëzgjatja

NENI 1

Emri dhe forma juridike

Shoqëria **Recruitment Affiliate sh.p.k.** (më poshtë e quajtur Shoqëria) është person juridik shqiptar i organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, që operon në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin në regjistrin tregtar.

NENI 2

Objekti i veprimtarisë

1. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e veprimtarisë private të ndërmjetësimit në punë, si agjenci private e punësimit e licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria ndërmjetëson për punësimin jashtë vendit të personelit të kualifikuar. Me synim përmbushjen e objektivit të veprimtarisë, Shoqëria bashkëpunon me partnerë vendas dhe të huaj.
2. Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, promocional dhe/ose tjetër, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

NENI 3


Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga Dervish Bej Mitrovica, pallati Kristi – Co, Nr. 6, Tiranë.

NENI 4

Kohëzgjatja

Shoqëria themelohet ditën e nënshkrimit të këtij akt themelimi për një kohëzgjatje të pacaktuar.



KREU II
Kapitali i Shoqërisë

NENI 5
Kontributi i Ortakëve

Kontributi i ortakut themelues të Shoqërisë është në para.

NENI 6
Kapitali i shoqërisë

1. Kapitali themeltar i shoqërisë, i përbërë nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

2. Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuotë.

Ortaku themelues Edra Voci zotëron kuotën me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) lekë, që përbën 100% të kapitalit.

NENI 7
Përgjegjësia e kufizuar e ortakëve

Ortaku nuk përgjigjet kundrejt palëve të treta përtej kontributit të tij.

KREU III
Administrimi i Shoqërisë

NENI 8
Administratori i Shoqërisë

Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Administrator i parë i Shoqërisë:

Zj. Irena Bakalli, shtetase shqiptare, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, lindur në Shkodër, më 18.04.1967, identifikuar përmes Nr. Personal G75418140V.

NENI 9
Përfaqësimi i Shoqërisë

Administratori përfaqëson ligjërisht Shoqërinë me palët e treta.

Nën përgjegjësinë e tij, Administratori mund të emërojë një apo më shumë përfaqësues të posaçëm apo të përgjithshëm për të kryer veprime në emër të shoqërisë.

NENI 10

Kompetencat e Administratorit

1. Administratori angazhon përgjegjësinë e tij kundrejt ortakëve në rast se kryen veprime që dalin përtej objektit të shoqërisë ose në rast se kryen veprime për të cilat nevojitet miratimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme.
2. Asambleja e Përgjithshme miraton, nëse e sheh të arsyeshme, një akt të posaçëm ku parashikohen veprimet për të cilat nevojitet pëlqimi paraprak i saj.
3. Asambleja e Përgjithshme vendos për të gjitha çështjet që tejkalojnë kompetencat e Administratorit.
4. Administratori, nën përgjegjësinë e tij, mund të asistohet nga kushdo person i zgjedhur prej tij dhe t'i delegojë atij/asaj disa prej kompetencave të tij për ushtrimin e funksioneve apo detyrave të caktuara.

NENI 11

Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës kundrejt shoqërisë apo palëve të treta qoftë për shkeljet e ligjeve që rregullojnë shoqëritë tregtare, qoftë për shkeljen e statutit apo për fajet e kryera në ushtrimin e detyrave të administrimit dhe menaxhimit të shoqërisë.

NENI 12

Shpërblimi i Administratorit

Administratori përfiton një shpërblim të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.


NENI 13

Kontrolli i administrimit

Ortakët kanë të drejtë të njihen me të gjitha veprimtaritë e shoqërisë dhe t'u vihen në dispozicion, në vendin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, dokumentet dhe librat kontabël të shoqërisë.

NENI 14

Dorëheqja dhe shkarkimi



1. Administratori mund të japë dorëheqjen duke respektur kushtet e përcaktuara në kontratën e shërbimit të lidhur midis tij dhe shoqërisë.
2. Administratori mund të shkarkohet në çdo çast nga Asambleja e Përgjithshme. Kjo dispozitë nuk çënon të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në kontratën e shërbimit.

KREU IV

Ortakët

NENI 15

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e këtyre vendimeve:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- shpërndarjen e fitimit;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.


NENI 16

Vendimmarrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime me tri të katërtat e votave për:
 - a. ndryshimet e statutit;
 - b. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - c. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Për raste të tjera, për sa e lejon ligji, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

NENI 17

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme



1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike.
2. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Ortakët janë të detyruar t'i komunikojnë Administratorit adresën e tyre të banimit dhe adresën elektronike. Administratori i vë në dispozicion çdo ortaku listën përkatëse.
4. Njoftimi në adresën e komunikuar nga ortakët konsiderohet i vlefshëm.
5. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga administratori dhe secili ortak. Administratori ose ortaku që thërret Asamblenë e Përgjithshme luan rolin e kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme dhe përgjigjet për rregullshmërinë e thirrjes, të votimit dhe të dokumentimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
6. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 18

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që është e nevojshme për të përmbushur detyrimet ligjore dhe për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

NENI 19


Procesverbali i mbledhjes se asamblesë

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
2. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
4. Vota e ortakëve shprehet me shkrim në një dokument të posaçëm ose vërtetohet nëpërmjet letrës apo postës elektronike të dërguar nga ortaku.
5. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
6. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

NENI 20

Mënyra e votës

1. Ortakët mund të votojnë duke marrë pjesë personalisht apo nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar në Asamblenë e Përgjithshme.



2. Ortakët mund të votojnë, gjithashtu, duke dërguar votën e tyre përmes një letre apo postës elektronike.

KREU V

Shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve

NENI 21

Bilanci dhe pasqyrat financiare

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
2. Administratori është përgjegjës për përgatitjen dhe depozitimin e bilancit kontabël dhe dokumenteve të tjera pranë organeve shtetërore, si edhe pagimin e tatimit mbi fitimin brenda afateve ligjore.

NENI 22

Destinimi i fitimit

Brenda afateve të përcaktuara në ligj, Asambleja e Përgjithshme merr vendim mbi destinimin e fitimit. Administratori është përgjegjës për depozitimin e këtij vendimi pranë organeve shtetërore brenda afateve ligjore.

NENI 23

Eksperti kontabël i jashtëm

Pasqyrat financiare të shoqërisë auditohen të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i jashtëm.

KREU VI


Dispozita të fundit

NENI 24

Ligji rregullues dhe juridiksioni

1. Ky Statut rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin e këtij Statuti, do t'i nënshtrohet për zgjidhje gjyqësore Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku ndodhet selia e Shoqërisë.

NENI 25



Regjistri Tregtar

Statuti do të depozitohet në Regjistrin Tregtar.

NENI 26


Gjuha

Ky Statut nënshkruhet në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë.

ORTAKU THEMELUES

Edra Voci


(Emër, Mbiemër)



(Nënshkrim)

Në Tiranë më 07/05/2021

Irene Belushi



AKT THEMELIMI I SHOQËRISË RECRUITMENT AFFILIATE SH.P.K.

Në datën e përcaktuar në fund të këtij dokumenti, ortaku themelues

Zj. Edra Voci, shtetase shqiptare, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, lindur në Bilisht, më 16.08.1986 identifikuar përmes Nr. Personal I658160270,

vendosi themelimin e kësaj Shoqërie, me termat si më poshtë:

NENI 1

Emri dhe forma juridike

Shoqëria **Recruitment Affiliate sh.p.k.** (më poshtë e quajtur Shoqëria) është person juridik shqiptar i organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, që operon në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 2

Objekti i veprimtarisë

1. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e veprimtarisë private të ndërmjetësimit në punë, si agjenci private e punësimit e licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria ndërmjetëson për punësimin jashtë vendit të personelit të kualifikuar. Me synim përmbushjen e objektit të veprimtarisë, Shoqëria bashkëpunon me partnerë vendas dhe të huaj.

2. Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, promociional dhe/ose tjetër, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

NENI 3

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga Dervish Bej Mitrovica, pallati Kristi – Co, Nr. 6, Tiranë.

NENI 4


Kohëzgjatja

Shoqëria themelohet ditën e nënshkrimit të këtij akt themelimi për një kohëzgjatje të pacaktuar.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuotë.



Ortaku themelues Edra Voci zotëron kuotën me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) lekë, që përbën 100% të kapitalit.

NENI 6 Organet e Shoqërisë

1. Organet e Shoqërisë janë:
 - a. Asambleja e Përgjithshme
 - b. Administratori

Organet e Shoqërisë funksionojnë në bazë të ligjit dhe statutit të Shoqërisë.

2. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm.
3. Administratori i Shoqërisë është **Zj. Irena Bakalli**, shtetase shqiptare, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, lindur në Shkodër, më 18.04.1967, identifikuar përmes Nr. Personal G75418140V.
4. Administratori emërohet nga Asambleja për një periudhë 3 (tre) vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.
5. Administratori përfaqëson ligjërisht Shoqërinë me palët e treta.

NENI 7 Pjesëmarrja në shoqëri të tjera

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat.

NENI 8 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve


Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin e këtij dokumenti, do t'i nënshtrohet për zgjidhje gjyqësore Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 9 Regjistrimi në Regjistrin Tregtar

Autorizohet Administratori ose çdo person i autorizuar prej tij për të kryer regjistrimin fillestar të shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Edra Voci
(Emër, Mbiemër)



(Nënshkrim)

Në Tiranë më 07.10.2021

